



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 4562/Prot.

Tiranë, më 21 07.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1655, datë 12.08.2013.

SHOQËRISË "ISFAT" SH.P.K  
Rruga "Vasil Shanto", Pallati nr.4, Shk nr.1, Apartamenti nr.10. Tiranë.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blokun "Vasil Shanto", Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË  
MINIERA

Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "ISFAT" sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1655, datë 12.08.2013, për mineralin Krom, në Objektivin "Trull, Surroj", Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2619, datë 07.06.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.4562, Prot, datë 08.06.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1655, datë 12.08.2013, për mineralin Krom, në Objektivin "Trull, Surroj", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me ndërprerjen e aktivitetit minerar, ku rezulton se në objekt nuk është punuar prej më shumë se një viti kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma "c" të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1655, datë 12.08.2013, për mineralin Krom, në Objektivin "Trull, Surroj", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1530, datë 24.12.2010, Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1655, datë 12.08.2013, për mineralin Krom, në Objektivin "Trull, Surroj", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ILIR BEJTJA**

